ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**210-23-14295-2-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: RI Tender Shërbime inxhinierike profesionale

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Al Group SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Ulpiane
(Adresa)

Prishtine ***10 000***
(Vendi) *(Kodi postar)*

044146818
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Gezim Sylaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpk.algroup@gmail.com
(Adresa elektronike)

15.01.2024

(Data e parashtrimit të ankesës) (Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1]Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

_____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 28.12.2023 Data e hapjes së ofertave: 16.01.2024 Kërkesa për rishqyrtim me dt:11.01.2024 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt:12.01.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ **Jo** ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 27 i LPP-së** **Neni 28 i LPP-së** **Neni 17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik** **Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne kemi analizuar dosjen e tenderit në lidhje me këtë projekt de kemi kërkesa që të ndryshohen kërkesat si më poshtë: -Ne dosjen e tenderit në nenin 9.1&9.2 të FDT, pika 7 është kërkuar: 7. Të prezantohet licenca certifikata e akreditimit për OE që oferton, ose nëse është me marrëveshje, të prezantohet marrëveshja e nënshkruar në prani të Noterit nga të dy kompanitë. Duhet të prezantohet licenca certifikata për kompaninë me të cilën lidhet marrëveshja. Kërkesa qe te ofrohen marrëveshjet e noterizuara ne konsiderojmë qe është mjaft diskriminuese dhe e panevojshme pasi qe kjo po paraqet kosto shtese, sepse ne rast te nevojës mund te vërtetohen nga autoriteti kontraktues edhe nese nuk janë te noterizuara andaj kërkojmë qe ky kriter te rishikohet. Thjesht kërkojmë që të ndryshohet kjo kërkesë dhe të mos kërkohen të noterizuara marrëveshjet.

-**Menaxheri i Projektit** - Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose hidroteknikë - (min.7 vjet nga diplomimi), i çertifikuar me VNM (vlerësimi i ndikimit në mjedis) dhe ISO 14001 2015 (auditor i brendshëm).
CV-a, Diploma (e noterizuar - vërtetim i kopjes nga origjinali nga vet inxhinieri), Kontrata e punës me ofertuesin ose marrëveshje e bashkëpunimit për që projekt – duke specifikuar emrin e projektit (kopje e noterizuar në prezencën e të dyja palëve) . Për stafin me kontratë të rregullt të paraqitet lista e ATK. Në pozitën e Menaxherit të Projektit, min. 3 projekte të projektimit në fushën e njëjtë (Rrugë, Ujësjellës, Kanalizime dhe Lumenj).

Kërkojmë qe ndryshohet kjo kërkesë sepse është pa nevojshme dhe është ne kundërshtim me ligjin, udhëzimet si dhe rregulloren e prokurimit publik.

- **Inxhinier i Arkitekturës** - Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës - (min. 5 vjet nga diplomimi). Në pozitën e Projektuesit, min. 3 projekte të projektimit për objekte të ndërtimit të lartë administrative te nivelit qendror ose komunal, sheshe dhe qendra qytetesh.

3% CV-a, Diploma (e noterizuar - vërtetim i kopjes nga origjinali nga vet Inxhinieri), Kontrata e punës me ofertuesin ose marrëveshje e bashkëpunimit për që projekt – duke specifikuar emrin e projektit (kopje e noterizuar në prezencën e të dyja palëve). Për stafin me kontratë të rregullt të paraqitet lista e ATK. Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.
Kërkojmë qe te ndryshohet kjo kërkesë dhe të largohen kërkesat për këto certifikime dhe referenca, sepse këto kërkesa janë diskriminuese dhe favorizuese.

- Inxhinier i Ndërtimit-Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv - (min. 2vjet nga diplomimi), i certifikuar me (ose të ngjashëm) .Në pozitën e Projektuesit, min. 3 projekte në fushën e projektimit ose mbikëqyrjes (statike) në ndërtim të lartë dhe te ulët.

CV-a, Diploma (e noterizuar - vërtetim i kopjes nga origjinali nga vet Inxhinieri), Çertifikatat – kopje e noterizuar Kontrata e punës me ofertuesin ose marrëveshje e bashkëpunimit për që projekt – duke specifikuar emrin e projektit (kopje e noterizuar në prezencën e të dyja palëve) . Për stafin me kontratë të rregullt të paraqitet lista e ATK. Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.
Edhe kërkesa për këto certifikime te tilla është kërkesë diskriminuese/favorizuese, andaj kërkojmë që të largohen nga dosja e tenderit sepse janë në kundërshtim me ligjin, udhëzimet si dhe rregulloren e prokurimit publik si dhe në kundërshtim me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit.

- Inxhinier i Ndërtimit - Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv – ose Bachelor (min. 5vjet nga diplomimi). Në pozitën e Projektuesit, min. 3 projekte në fushën e projektimit ose mbikëqyrjes (statike) në ndërtim të lartë dhe te ulët.

CV-a, Diploma (e noterizuar - vërtetim i kopjes nga origjinali nga vet Inxhinieri), Kontrata e punës me ofertuesin ose marrëveshje e bashkëpunimit për që projekt – duke specifikuar emrin e projektit (kopje e noterizuar në prezencën e të dyja palëve) . Për stafin me kontratë të rregullt të paraqitet lista e ATK. Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.
Edhe këto kërkesa janë diskriminuese dhe favorizuese për kompani të caktuara, prandaj duhet të largohen kërkesat për këto certifikime sepse nuk janë në harmoni me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit.

- Inxhinier i Ndërtimit –- Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë ose Bachelor – Hidroteknikës - (min. 5 vjet nga diplomimi), i çertifikuar në BIM – ose te ngjajshme. Në pozitën e Projektuesit ose Mbikqyrësit, min. 3 projekte të projektimit ose mbikëqyrjes në fushën e njëjtë (Rrugë, Ujësjellë, Kanalizime dhe Lumenj, Impiante për trajtimin e ujrave te zeza).

5% CV-a, Diploma (e noterizuar - vërtetim i kopjes nga origjinali nga vet Inxhinieri), Çertifikatat – kopje e noterizuar. Kontrata e punës me ofertuesin ose marrëveshje e bashkëpunimit për që projekt – duke specifikuar emrin e projektit (kopje e noterizuar në prezencën e të dyja palëve) . Për stafin me kontratë të rregullt të paraqitet lista e ATK. Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.
Kërkesa e tille është pa nevojshme me certifikime te tilla andaj kërkojmë që të largohet kërkesat për certifikime dhe noterizime, sepse këto kërkesa janë ne kundërshtim me ligjin, udhëzimet si dhe rregulloren e prokurimit publik dhe në kundërshtim me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit.

- Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes – drejtimi Energjetike (min.7 vjet nga diplomimi), i certifikuar si auditor i energjisë në ndërtesa dhe ndriçim publik konform legjislacionit vendor. Në pozitën e Projektuesit, min. 3 projekte të projektimit në fushën e njëjtë (Rrugë, Ujësjellës, Kanalizime dhe Lumenj, Impiante për trajtimin e ujrave te zeza, Stacione pompimi, Rezvuare). 5% CV-a, Diploma (e noterizuar - vërtetim i kopjes nga origjinali nga vet Inxhinieri), Kontrata e punës me ofertuesin ose marrëveshje e bashkëpunimit për që projekt – duke specifikuar emrin e projektit (kopje e noterizuar në prezencën e të dyja palëve). Për stafin me kontratë të rregullt të paraqitet lista e ATK. Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

- Inxhinier i Makinerisë Eksperienca profesionale-Inxh.dipl.mak. – drejtimi Termoenergjetike me termoteknike, - (min.7 vjet nga diplomimi). Në pozitën e Projektuesit, min. 3 projekte të projektimit ose mbikëqyrjes në fushën e ndërtimit të lartë dhe ndërtim të ulët. 5% CV-a, Diploma (e noterizuar - vërtetim i kopjes nga origjinali nga vet Inxhinieri), Kontrata e punës me ofertuesin ose marrëveshje e bashkëpunimit për që projekt – duke specifikuar emrin e projektit (kopje e noterizuar në prezencën e të dyja palëve) . Për stafin me kontratë të rregullt të paraqitet lista e ATK.

Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

- Inxhinier i Gjeodezisë – Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë – ose Bachelor (min 5 vjet nga diplomimi), i licencuar sipas legjislacionit në Republikën e Kosovës, i Certifikuar për përdorim të Dronit Profesional. Në pozitën e Projektuesit, min. 3 projekte të projektimit ose mbikëqyrjes në fushën e njëjtë (Rrugë, Ujësjellës, Kanalizime dhe Lumenj, Impiante per trajtimin e ujrave te zeza). 5% CV-a, Diploma (e noterizuar - vërtetim i kopjes nga origjinali nga vet Inxhinieri), Kontrata e punës me ofertuesin ose marrëveshje e bashkëpunimit për që projekt – duke specifikuar emrin e projektit (kopje e noterizuar në prezencën e të dyja palëve) . Për stafin me kontratë të rregullt të paraqitet lista e ATK. Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

- Ekspert i Gjeomekanikes – Inxhinier i diplomuar i Gjeoteknikes ose Ndërtimtarisë më eksperiencë ne gjeomekanike. - (min.5 vjet nga diplomimi). Në pozitën e Projektuesit, min. 3 projekte të projektimit në shqyrtime dhe hartimet e elaborateve/raporteve gjeomekanike dhe ekzaminimeve në teren në fushën e njëjtë (Rrugë, Ujësjellë, Kanalizime dhe Lumenj, Impiante per trajtimin e ujrave te zeza) 5% CV-a, Diploma (e noterizuar - vërtetim i kopjes nga origjinali nga vet Inxhinieri),

Kontrata e punës me ofertuesin ose marrëveshje e bashkëpunimit për që projekt – duke specifikuar emrin e projektit (kopje e noterizuar në prezencën e të dyja palëve) . Për stafin me kontratë të rregullt të paraqitet lista e ATK. Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

Për të gjithë inxhinierët e lartcekur kërkojmë që të largohen kërkesat për certifikime dhe noterizim sepse nuk përkojnë me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit dhe përbëjnë diskriminim/favorizim

të hapur.

- Ekspert i Gjeologjise – Inxhinier i diplomuar i Gjoelogjisë,– së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit, projekte te realizuara në lëmin e kërkuar.

Në pozitën e Inxhinierit, min. 3 projekte të projektimit në shqyrtime dhe hartimet e elaborateve/raporteve gjeomekanike/gjeologjike dhe ekzaminimeve në teren në fushën e njëjtë (Rrugë, Ujësjellë, Kanalizime dhe Objekte)

5% CV-a, Diploma (e noterizuar - vërtetim i kopjes nga origjinali nga vet Inxhinieri), Kontrata e punës me ofertuesin ose marrëveshje e bashkëpunimit për që projekt – duke specifikuar emrin e projektit (kopje e noterizuar në prezencën e të dyja palëve). Për stafin me kontratë të rregullt të paraqitet lista e ATK. Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

Edhe kjo kërkesë është ne kundërshtim me ligjin, udhëzimet si dhe rregulloren e prokurimit publik dhe është diskriminim i hapur për kompanitë me përvojë në këtë fushë

Ne dosje është kërkuar Dron në pronësi i dedikuar për inspektim, monitorim apo relivim gjeodezik, i pajisur me kamera dixhitale me rezolucion jo më pak se 40 megapixel. Droni duhet të ketë mundësin e matjes me PPK dhe softuerin e procesimit PPK. Të prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i Dronit dhe kamerës.

Një Dron me sensor LIDAR, i dedikuar për inspektim, monitorim apo rivelim gjeodezik. Të prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i dronit dhe sensorit LIDAR, për shkak të monitorimit të punimeve në pozicione të vështira, LIDAR sensori duhet të ketë mundësin e matjeve në shumë platforma si makinë, ecje ose përmes fluturimit.

Kërkojmë që të ndryshohet kjo kërkesë sepse droni me lidar si dhe droni me nje specifikacion te kameres se till sipas kërkesës është vetëm një kërkesë diskriminuese si dhe nje kërkesë e cila është ne kundërshtim me ligjin, udhëzuesit dhe rregullat e prokurimit publik.

Kjo kërkesë përbën favorizim të hapur për kompani të caktuar kurse diskriminim për shumë kompani të tjera serioze.

Ne kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt.12.01.2024 ku është refuzuar kërkesa jonë si e pabazuar.

Vendimi për refuzim është shumë kundërthënës sepse në njërën anë e konsideron si të jashtëafatshme kërkesën për rishqyrtim, ndërsa në anën tjetër i ka shqyrtuar pretendimet tona ankimore duke i cilësuar si të pabazuara.

Ju sqarojmë se kërkesa për rishqyrtim është brenda afatit ligjor dhe po ashtu pretendimet tona ankimore janë të bazuara, sepse kemi diskriminim të hapur me kërkesa e tilla të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Dosja e përgatitur në këtë mënyrë, bie ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6.

Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Me këto kërkesa dhe me këtë dosje, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur të operatorëve ekonomik që merren me punë dhe që janë profesional në këtë lëmi.

Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit".

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton nuk është përpiluar dosja e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është marr

parasysh as neni 17.17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që **nuk**: **Kufizon konkurrencën** në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve".

Neni 25.6 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik e parasheh qartë "Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim **do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale** për objektin e kontratës në fjalë. Në këtë tender kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit nuk janë proporcionale me objektin e kontratës dhe natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit dhe janë kërkesa të panevojshme.

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit edhe shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se "Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike".
Me këto kërkesa, jo vetëm që nuk i është kushtuar rëndësi operatorëve ekonomik të ri, por i është kufizuar konkurrenca edhe operatorëve ekonomik me përvojë dhe me stabilitet ekonomiko financiar dhe me aftësi teknike profesionale, prandaj duhet ndryshuar/larguar këto kërkesa që të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë e operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit dhe të merret parasysh edhe dispozita e lartpërmendur (25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik). Po ashtu duhet të ndahet në Lote ky aktivitet i prokurimit.
Pra, në vend se të merret parasysh edhe zhvillimi i operatorëve ekonomik të rinjë, në këtë rast përveç se nuk është marr parasysh kjo dispozitë, janë diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë, me më shumë përvojë në këtë fushë siç është ky aktivitet i prokurimit. Pra është kufizuar konkurrenca

Kërkesat të cilat i kontestuam më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet e lartcekura dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa OE **"Al Group" SHPK** si e bazuar,
NDRYSHOHEN kërkesat, që u cekën më lartë dhe të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Për momentin nuk kemi dëme, pasi që jemi në fazën e tenderimit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*